

LIQENI KOMO - LUGANO - MILANO Nisje: • 15 Maj

DESTINACIONI

Milano - liqeni Komo -
Lugano

PERIUDHA

Prill-Maj '2026

KOHËZGJATJA

3 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion

PËRMBLEDHJE

JUL

17

MAJ 2026



Nisje 15 Maj - Kthim 17 Maj

- 3 Ditë / 2 Netë
- Çmimi: **399€**
-  Nisja: 09:45 (Tiranë) → 11:30 (Milano)
-  Kthimi: 19:40 (Milano) → 22:15 (Tiranë)

1

Dita 1: LUGANO

DITË

Takimi në aeroportin e Tiranës me shoqëruesin 2 orë përpara fluturimit.

Fluturimi direkt Tiranë - Milano. (1 orë e 40 min)

Pas mbërritjes në Bergamo udhëtojmë me autobuz për në **Lugano**, për të vizituar qytetin zvicerian dhe atraksionet kryesore të tij si: **Katedralja San Lorenzo, Kisha Santa Maria, Parco Ciani, Piazza della Riforma etj.**

Qendra e qytetit me sheshet dhe arkadat e stilit mesdhetar, dhe parqet e shumta me bimë subtropikale si Parco Civico në brigjet e liqenit ju ftojnë të shëtisni dhe shijoni atmosferën. Pranë shëtitores buzë liqenit ndodhen edhe Kopshtet Belvedere, ku parku krenohet jo vetëm me Kamelitë (të njohura si trëndafilat e dimirti) dhe Vjollcat, por edhe bimët e panumërta subtropikale dhe veprat moderne të artit.

Pas vizitës në Lugano kthimi për në Milano.

Akomodimi në hotel.

Mbrëmje e lirë.

Mëngjesi në hotel.

Nisja me autobus për në **Liqenin Como**, liqeni i tretë më i madh në Itali dhe një nga destinacionet më romantike dhe piktoreske në Evropë. I vendosur në rrëzë të Alpeve, liqeni ofron peizazhe mahnitëse, ndërthurje të natyrës me arkitekturën elegante dhe një atmosferë unike relaksi. Forma e tij karakteristike në trajtë “Y-je” të përmbysur vjen si rezultat i shkrijës së akullnajave dhe veprimt të lumit Adda.

Mbërritja në **qytetin e Comos**, një nga pikat kryesore të liqenit. Vizitë në qendrën historike, ku do të shijojmë rrugicat mesjetare, sheshet karakteristike dhe atmosferën autentike italiane. Vizitohen:

- **Katedralja e Comos (Duomo)**, një nga më të bukurat në Lombardi
- **Qendra historike** me dyqane tradicionale dhe tregje lokale
- **Bulevardi buzë liqenit**, ideal për shëtitje dhe foto panoramike
- **Tempulli i Alessandro Volta** dhe parku përreth **Villa Olmo** (vizitë e jashtme)

Mundësi (opsionale) për të marrë **teleferikun për në Brunate**, për të shijuar pamje spektakolare nga lart mbi liqen dhe qytet.

OPSIONALE - Lundrim në Liqenin Como (rreth 15€ / person, paguhet në vend)

Një eksperiencë e rekomanduar për të zbuluar bukurinë e plotë të liqenit, në shoqërinë e guidës:

- **Cernobbio** – ndalesa e parë, qytet elegant i njohur për vilat luksoze si **Villa d’Este**, **Villa Erba**, **Villa Pizzo** dhe **Villa Bernasconi**, të rrethuara nga kopshte të mrekullueshme
- **Bellagio** – “perla e liqenit Como”, një nga qytetet më të bukura në Itali. Shëtitje në qendrën plot jetë me rrugica shumëngjyrëshe, vizitë në **Parkun e Villa Serbelloni** dhe **Kopshtet e Villa Melzi**
- Shëtitje në zonat karakteristike **Pescallo** dhe **San Giovanni**, që ruajnë sharmin autentik
- Ndalesë në **Punta Spartivento**, për pamje të jashtëzakonshme mbi tre degët e liqenit dhe zonën përreth

Për klientët që nuk zgjedhin opsionin e lundrimit, pas vizitës së qytetit të Comos me guidën, kohë e lirë për shëtitje, kafe apo shopping.

Në përfundim të programit, kthimi me autobus në hotel.

Mëngjesi në hotel.

Fillimi i vizitës në qendrën e **Milanos**, një nga qytetet më të rëndësishme të Italisë dhe kryeqyteti i modës dhe dizajnit. Gjatë turit do të vizitohen:

- **Castello Sforzesco (Kështjella Sforza)** (vizitë e jashtme), një nga monumentet historike më të rëndësishme të qytetit
- **Sheshi Duomo** dhe **Katedralja e Milanos (Duomo)**, një nga katedralet më madhështore në botë
- **Galeria Vittorio Emanuele II**, një nga qendrat tregtare më të vjetra dhe elegante në Evropë
- **Teatri La Scala** (vizitë e jashtme), një nga teatrot më të famshëm të operas në botë

Pas përfundimit të vizitës, kohë e lirë për shopping dhe shëtitje individuale në Milano

Pasditja transfera për në aeroport dhe kryerja e procedurave të nisjes.

Fluturimi direkt Milano - Tiranë (rreth 1 orë e 30 minuta).

ÇFARË PËRFSHIHET

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Biletat e avionit Tirane - Milano - TiraneTransport me autobus sipas programitAkomodimi ne hotel per 2 nete ne zonën e Monzes me mengjesGuida në gjuhën shqipe gjatë turitLejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa 40cm x 30cm x 20cm deri në 10 kg. (Kujdes - Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe DarkatBiletat e hyrjes në Muze dhe Monumente TuristikeTaksat lokale 10 euro personi për 2 netet (e detyrueshme dhe paguhet ne zyrë bashkë me pagesën e turit)Anija 20 euro personi per turin opsional Komo - Cernobbio - Bellagio

VENDTAKIMI I NISJES

► Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

► Fëmijët në moshën 2 - 11.99 vjeç përfitojnë 40€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn ne fuqi vetëm nëse femijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj

2) Nuk duhet të keni kaluar në 3 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 30% mbi çmimin për person.
 - Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
 - Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do jetë standart, atëherë do jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
 - Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadenca e mjetit identifikues, etj.
 - Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
 - Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
 - Cmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.

INFORMACIONE

DESTINACIONI	Milano - liqeni Komo - Lugano
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€399.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	97% (€10.00)

